




Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1296 Data: 30.03.2021

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113( Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037(Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 85-të, të mbajtur më 21 Janar 2021, mori:

## V E N D I M

- I. Akreditohen programet e studimit në Kolegjin Biznesi për periudhën tre vjeçare 1 tetor 2020 – 30 shtator 2023:
  - Menaxhimi i emergjencave, MA, 120 ECTS, maksimumi 90 studentë për vit akademik
- II. Nuk akreditohet programi i studimit në Kolegjin Biznesi:
  - Menaxhment dhe Financa, MA, 120 ECTS
- III. Ndalohet regjistrimi i studentëve të rinj për të gjitha programet e studimit me akreditim valid të Kolegjit Biznesi deri në periudhën e riakreditimit institucional.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## Arsyetimi

I. Kolegji Biznesi ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për akreditim të programeve të studimit të cekura në dispozitivin të këtij vendimi.

AKA ka organizuar vizitën e akreditimit në Kolegjin Biznesi më datë 13.12.2019 me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit më këtë përbërje: Prof. Dr. Magdalena Platis, Prof. Dr. Peter Mertens dhe Znj. Oana Sarbu.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 22.01.2021 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit Biznesi dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit

të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Sa i përket programit të studimit Menaxhimi i Emergjencave, MA, ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit kanë konstatuar se ky program i studimit plotëson substancialisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit.

Sa i përket programit të studimit Menaxhment dhe Financa, MA, ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit kanë konstatuar se ky program i studimit plotëson pjesërisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Ekspertët kanë konstatuar se nga gjithsej shtatë (7) kapituj të standardeve të Manualit të Akreditimit, Kolegjit-Biznesi për këtë program të studimit plotëson tre (3) substancialisht dhe (4) pjesërisht, dhe rrjedhimisht kanë rekomanduar mosdhënien e akreditimit.

Sa i përket fushës së standardeve që ka të bëjë me misionin, objektivat dhe administratën, ekipi i ekspertëve ndër të tjera ka konstatuar se misioni i programit është identik me misionin e institucionit dhe se rezultatet e të nxëniet nuk janë të paraqitura në mënyrë të qartë. Për më tepër ekspertët kanë vërejtur se lëndë të caktuara të programit nuk janë në përputhje me nivelin master sa i përket përmbajtjes së dicitlinave.

Sa i përket fushës së standardeve që ka të bëjë me procesin mësimor dhe përmbajtjen, ekspertët kanë konstatuar se disiplinat në kuadër të kurrikulës janë të organizuara në mënyrë të paqartë. Disa disiplina të përgjithshme që duhet të ofrohen në nivel bachelor, janë të përziera me disiplina tjera që janë më konkrete. Rezultatet mësimore për programin e studimit nuk janë të formuluar qartë. Pos kësaj ekspertët kanë gjetur se në disa silabuse 1 ECTS kredi korrespondon me 25 orë, kurse në silabuse tjera 30 orë, duke e bërë të paqartë ngarkesën e studentëve në procesin e të nxëniet.

Sa i përket fushës së standardeve "Hulumtimi shkencorë" ekipi i ekspertëve të akreditimit kanë gjetur se Kolegji Biznesi nuk ka një plan të hulumtimit shkencorë. Po ashtu ekspertët kanë konstatuar se buxheti i institucionit kryesisht bazohet në pagesat e studentëve dhe institucioni nuk ka për qëllim të aplikojë për burime të jashtme të financimit dhe nuk parasheh të hyra nga hulumtimi shkencorë.

Megjithëse raporti i vetëvlerësimit të institucionit potencon se Kolegji Biznesi është pjesë e disa projekteve ndërkombëtare, ekipi i ekspertëve ka konstatuar se të gjitha projektet ku institucioni ka qenë i përfshirë kanë përfunduar në vitin 2015, dhe se në vitet e fundit institucioni nuk ka zbatuar asnjë projekt ndërkombëtar.

Sa i përket infrastrukturës, ndër të tjera, ekipi i ekspertëve ka konstatuar se objekti ku kolegji organizon aktivitetin e tij nuk është tërësisht adekuat për aktivitete akademike. Ka shumë hapësira ku mungon ndriçimi natyral, përfshirë këtu edhe laboratorin e teknologjisë informative. Po ashtu, për numrin e studentëve që kolegji Biznesi ka kërkuar për këtë program është e pamundur të organizohen aktivitete didaktike, së bashku me studentët e programeve tjerë të cilat aktualisht ofrohen nga Kolegji. Kolegji Biznesi, sipas ekipit të ekspertëve, nuk ka hapësira rekreative, bufe, sallë sporti e shërbime mjekësore. Objekti nuk është i përshtatshëm për studentë me nevoja të veçanta.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti

AKA - Agjencia e Kosovës për Akreditim

administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Biznesi;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

